

Data 09.06.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Shërbime për mirëmbajtjen e automjeteve të DPÇK.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50112000-3

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 195 905.45 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesë pikë dyzetë e pesë) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 OE duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se ka në stafin e tij të paktën 3 punonjës të specializuar, dhe punësuar, në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës për profilet si më poshtë:

- 1 (një) **inxhinier mekanik**
- 1 (një) **mekanik**
- 1 (një) **specialist-motorist**
- 1 (një) **specialist-elektroaut**
- 1 (një) **specialist-pompist**

- Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë:

- për **inxhinierin mekanik**

- Diplomën përkatëse,
- Dëshmi Aftësie Profesionale, në fushën e aktivitetit të autoriparimit, në cilësinë e përgjegjës të teknik të subjektit.

- për **mekanikun**

- Certifikatë/dëshmi/diplomë kualifikimi, lëshuar nga shkolla e mesme profesionale apo institucione jo-publike të akredituara.

- për **specialistin-motorist**

- Dëshmi/Certifikatë kualifikimi

- për **specialistin-elektroaut**

- Dëshmi/Certifikatë kualifikimi

- për **specialist-pompist**

- Dëshmi/Certifikatë kualifikimi

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Kërkesa e AK që OE duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se ka në stafin e tij të paktën 3 punonjës të specializuar, dhe punësuar, në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës për profilet inxhinier mekanik, mekanik, specialist motorrist, specialist elektroaut, dhe specialist pompist është në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysht zërat përkatës të shërbimeve për secilin automjet si dhe kualifikimin e duhur profesional që duhet të kenë specialistët që do të kryejnë diagnostikimin dhe riparimin e tyre.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2021, 2022 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) :

Kategoria: Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor

Nën Kategoria: Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

Kodi: VII.3.B.1

(shënim-përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: *Kriteri që OE duhet të disponojë Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006, "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to"*

-VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, "Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" e ndryshuar.

-Udhëzim Nr. 1546, datë 29.03.2016, "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove".

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)

2.3.3. Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- *Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë", lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi.*
- *Certifikate ISO 14001:2015, ose ekuivalente me të "Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit", lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi.*

Ne rastin e BOE certifikatat duhet te paraqiten nga secili prej anëtareve të BOE.

Argumentimi: *Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë", është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron.*

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën ISO 14001:2015, ose ekuivalente me të "Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit", lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të mjedisit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqes një vetdeklarim ku të deklaroje se disponon një oficinë për riparimin e automjeteve në pronësi/ përdorim/ marrëveshje bashkëpunimi, sipas kontrates noteriale, me parkim.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë:

- Certifikatën e pronësisë dhe/ose kontratën e qerasë dhe/ose marrëveshjen e bashkëpunimit për oficinën, të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa që OE duhet të disponojë një oficinë për riparimin e automjeteve në pronësi/ përdorim/ marrëveshje bashkëpunimi, sipas kontrates noteriale, me parkim, është vendosur për të garantuar që OE ka në dispozicion ambientet e përshtatshme me hapësirat e mjaftueshme për kryerjen e shërbimeve si dhe për të përcaktuar vendodhjen se ku do të kryhen shërbimet e kërkuara për automjetet. Kërkesa që OE duhet të paraqesë një deklaratë, me foto bashkëlidhur, ku të deklarojë se disponon pajisjet urë vinç dhe paisje kompjuterike për diagnostikimin e automjeteve të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme për kryerjen e shërbimeve të kërkuar dhe realizimin e kushteve kontraktuale.*

2.3.5 OE duhet të paraqes një vetdeklarim, me foto bashkëlidhur, ku të deklarojë se disponon pajisjet dhe mjetet si më poshtë:

- 1 (një) ura – vinç për ngritjen e automjeteve.
- 1 (një) paisje kompjuterike për diagnostikim të automjeteve.

Argumentim: *Kërkesa që OE duhet të paraqesë një deklaratë, me foto bashkëlidhur, ku të deklarojë se disponon pajisjet urë vinç dhe paisje kompjuterike për diagnostikimin e automjeteve të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme për kryerjen e shërbimeve të kërkuar dhe realizimin e kushteve kontraktuale.*

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon **1 (një) automjet karrotrec** për transportin e automjeteve në rast defektesh, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet karrotrec, në pronësi ose në përdorim sipas kontrates noteriale, të vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)

- certifikatë e kontrollit teknik

Në rastin kur automjeti është me qera, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa që OE duhet të deklarojë se dispon 1 (një) automjet karrotrec për transportin e automjeteve në rast defektesh, për të cilin duhet që për periudhën e zbatimit të kontratës, është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës duke patur parasysh se për kyerjen e shërbimeve të kërkuara për automjetet, secili prej tyre duhet të shkojë pranë “pikës së servisit” të kontraktorit. Duke qene se të gjitha automjetet e kryejnë aktivitetin e tyre brenda qytetit të Tiranës, ku ato mund të bëjnë defekte të mundshme, si dhe duke patur parasysh natyrën delikate të punës së tyre që është shpërndarja e ushqimeve, detergjenteve dhe materialeve të tjera në kopshtet dhe çerdhet e Tiranës, dhe se ky aktivitet është ditor dhe nuk duhet të ndërpritet asnjë ditë, shërbimi i riparimit të tyre duhet të kryhet sa më shpejtë, brenda ditës për t’i rikthyer ato në detyrë, duke minimizuar në maksimum kohën e transportit deri në pikën e servisit dhe kohën e kryerjes së servisit.

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer duke iu referuar kërkesave të shoferëve të automjeteve për problemet teknike që ata konstatojnë në mjetet e tyre por edhe duke parashikuar nevojat në vazhdim për shërbime, në mënyrë që automjetet të jenë në shërbim të plotë çdo ditë në zbatim të detyrave funksionale që ato kanë, në bashkëpunim me specialistin e fushës të përcaktuar nga Bashkia e Tiranës.

Sqarojmë se automjetet e mësipërme kryejnë çdo ditë një aktivitet intensiv pa ndërprerje, me ngarkesë të plotë, gjatë gjithë orarit të punës, në funksion të shpërndarjes së produkteve ushqimore, materialeve të pastrimit dhe materialeve të inventarit, në të gjitha çerdhet dhe kopshtet e qytetit të Tiranës.

Për përgatitjen e specifikimeve teknike për riparimin e automjeteve, Komisioni i është referuar gjendjes aktuale të automjeteve, vitit të prodhimit, problemeve të konstatuara nga ana e shoferave të automjeteve, duke përcaktuar jo vetëm problematikat që aktualisht po shfaqin, por duke parashikuar edhe përballimin e problemeve të ndryshme, të mundshme gjatë gjithë vitit 2023.

Duke iu referuar specifikave teknike të secilit nga automjetet, janë përcaktuar zërat e shërbimeve të parashikuar për t'u kryer, sasia e vajit të motorrit të nevojshëm për çdo automjet, tipi dhe numri përkatës i vajit motorrik që i përshatet atij automjeti, pjesët e këmbimit të nevojshme të parashikuar për tu ndërruar gjatë zbatimit të kontratës.

Për secilin automjet janë paraqitur të dhënat specifike të automjetit si dhe numri përkatës i shasisë, me anë të të cilit OE konkurues të orientohen saktësisht për pjesët e këmbimit të kërkuara.

Për sa i përket shërbimeve të kërkuara në sistemin elektrik, në sistemin e ushqimit me karburant, në sistemin motorrik dhe shërbime llamarinisti, për çdo automjet, brenda këtyre zërave janë parashikuar pjesë të ndryshme këmbimi të cilat mund të nevojiten gjatë periudhës së zbatimit të kontratës gjatë aktivitetit ditor të automjetve, për të cilat OE kontraktor do të njoftohet nga AK rast pas rasti për secilën prej tyre.

Në shërbimet e parashikuara janë përfshirë pjesët e këmbimit, furnizimi dhe vendosja e tyre në automjetin përkatës.

Për sa i përket dy automjeteve të reja të blera në vitin 2022, sqarojmë se ato janë në gjendje shumë të mirë, nuk është konstatuar asnjë problem në aktivitetin e tyre. Shërbimi i vetëm për të cilin ato kanë nevoj janë shërbime priodike si ndërrimi i vajit të motorrit dhe filtrave, ndërrimi i ferrotave të frenimit, furnizimi me lëndë “Ad blue” si dhe kontrolli dhe nëse do të jetë e nevojshme riparimi sitetmit të emetimit të gazrave, për arsye se ato punojnë vetëm brenda qytetit të Tiranës me shpejtësi të reduktuar gjatë gjithë aktivitetit të tyre.